



Raport përmbledhës mbi aktivitetet e kryera në kuadër të hartimit të Projekt Propozimit bazuar në iniciativat e zhvillimit të kapaciteteve përgjatë zinxhirit të vlerës së Frutave dhe Arroreve

---



Vendndodhja: Korçë, Dibër, Kukës

Programi: SARED

Periudha: 12 Nëntor 2015-  
29 Shkurt 2016

Data e raportit: 29/02/2016

**Përgatitur nga: ADAD Malore**

Dr. Hafuz DOMI

## Tabela e permbajtjes

<b>1. Përmbledhje e raportit</b> .....	3
1.1. Takime me kordinatorët lokal të SARED.....	3
1.2. Takime me Drejtuesit lokal të Drejtorive të Bujqësisë dhe QTTB Korçë.....	3
1.3. Takim me konsulentët, lehtësuesit dhe ekspertët e ADAD Malore në Tiranë.....	4
1.3.1. Takimet e lehtësuesve me grupet.....	4
1.3.2. Takimet e keshilluesve me grupet:.....	5
1.4. Produkti i punës 10 javore me 14 grupet.....	6
1.4.1. Përcaktimi i produkteve;.....	6
1.4.2. Organizimi i gjashtë grupeve;.....	7
1.4.3. Memorandumet.....	7
1.4.4. Projekt propozimi – Draft,.....	7
1.5. Mobilizimi i ekipit teknik dhe të eksperteve që janë përfshirë në projekt propozim.....	8
1.6. Mobilizimi i aktoreve Korçë.....	8
<b>2. Disa ndryshime në lidhje me iniciativat</b> .....	9
<b>Annex 1</b> .....	10

## Lista e tabelave

Tabela 1: 150914 Tabela përmbledhëse e termave të referencës - Iniciativat e ADAD Malore.....	10
Tabela 2: 1a. Lista e lehtësuesve, specialistëve të DB/QTTB Korçë dhe ekspertëve të ADAD.....	11
Tabela 3: Lista e lehtësuesve, specialistëve të DB Diber dhe ekspertëve të ADAD.....	11
Tabela 4: Lista e lehtësuesve, specialistëve të DB Kukës/Has dhe ekspertëve të ADAD.....	11
Tabela 5: Lista përmbledhëse të 14 grupeve.....	12

## 1. Përmbledhje e raportit

Mbështetur në kontratën e Programit “Mbështetje për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural në zonat e pafavorizuara në Shqipëri” SARED dhe termat e referencës për Iniciativat mbi aktivitetet e rritjes së kapaciteteve në zinxhirin e vlerës së Frutave dhe Arroreve, ADAD ka zbatuar aktivitetet e nevojshme për 3 Iniciativa dhe 14 grupe ne Rajonin e Korces, Dibres dhe Kukesis. Për Korçën Iniciativen WS 4-1a (6 grupe), dhe WS 4-5a (2 grupe), per Dibren WS 4-4a (2 grupe) dhe WS-2a, 1 grup ne Diber dhe 3 grupe ne Kukes, inicitiva keto te parashikuara nga termat e references (shih aneksin 1).

### 1.1. Takime me kordinatorët lokal të SARED

Per fillimin e punes kemi njoftuar kordinatorët lokal të projektit SARED, per Korçën znj. Xheni Prenda, për Dibren z. Dali Horeshka dhe per Kukesisin z. Dritan Tahiraj, te cileve u kemi percjelle dhe programin e punes te takimeve te facilitatorve me fermeret dhe grupet dhe te eksperteve te ADAD Malore (shih aneksin 1). Gjithashtu ne kemi raportuar ne menyre periodike me kordinatorët lokal te SARED per ecurine e zbatimit te programit sipas iniciativave. Gjithashtu kordinatorëve lokal te SARED u jane derguar edhe versionet paraprake te projekt propozimet perkatese ne menyre qe te merren parasysh edhe komentet apo sugjerimet e tyre ne pergatitjen e versionit final.



### 1.2. Takime me Drejtuesit lokal te Drejtorive te Bujqesise dhe QTTB Korçe

Ne vazhdim ne kemi realizuar takime me Drejtoret e Bujqesise Korce z. Vullnet Gjolla, te Dibres z. Novruz Jashari, te Kukesis z. Alfred Cengu. Gjithashtu ne kemi bere takim dhe me Drejtorin e QTTB Korçe z. Roland Meçaj. Ne keto takime ne kemi shpjeguar programin e SARED per komponentin e rritjes e kapaciteteve (CD) per zinxhirin e vlerave te frutave dhe arroreve, per iniciativat dhe grupet perkatese sipas rajoneve. Synimi i



ketyre takimeve ka qene arritja e nje angazhimi te perbashket per te realizuar objektivat sipas termave te references te percaktuara nga SARED. Nga te gjithë drejtuesit lokal te bujqesise, ne kemi pasur mbeshtetje, te cilet kane angazhuar specialistet e ekstensionit, qe kane punuar me lehtesuesit. Lehtesuesit jane perzgjedhur me konsensus te perbashket DB - ADAD Malore. Ne takimet me grupet kane marre pjese 10 specialiste te ekstensionit nga te tre drejtorite rajonale dhe 1 specialiste i QTTB Korce me grupet e Korçes. (shih aneks 1). Ne takimet me grupet ka pasur nje koherence ne trajtimin e problemeve dhe te aktiviteteve te grupeve te cilat jane pasqyruar ne projekt propozimet sipas iniciativave.

### 1.3. Takim me konsulentet, lehtësuesit dhe ekspertet e ADAD Malore ne Tirane

Adad Malore ka organizuar nje takim (trajnim) me 4 facilitatoret e grupeve te Korçes (Mehmet Pupa, Adlir Krushova), te Dibres (Burhan Shehi), te Kukesit (Mevlan Cahani) dhe ekspertet e ADAD – Dr. Hafuz Domi, Liljana Isakaj, Kadri Malja dhe Blendi Shima ne Tirane. Ne njohem facilitatoret dhe ekspertet me kontraten me SARED, me objektivat dhe aktivitetet sipas termave të referencës. Ata u trajnuan per menyren e identifikimit te prodhuesve, organizimin e grupeve, kordinimin e punes me specialistet e Drejtorise Bujqesise, per dokumentacionin (timesheet, listat e pjesemarreve, proces verbalet e mbledhjeve), hartimin e programit te punes 10 javore dhe raportimin ne ADAD Malore. Ne kemi pergatitur nje pyetesor per facilitotoret per menyren se si te trajtojne ceshtjet dhe te marrin informacionin e nevojshme ne takimet me fermeret dhe me grupet e synuara.

#### 1.3.1. Takimet e lehtësuesve me grupet

Sipas programit gjate periudhes 10 javore lehtesuesit kane realizuar kontaktet per identifikimin e fermerve, te cileve u është shpjeguar mundesia qe ju ofron SARED per te punuar ne grup rreth nje produkti te cilin e kane si aktivitet kryesor, ne funksion te permiresimit te teknologjise se kultivimit, rritjes se rendimentit dhe te ardhurave. Ata kane organizuar takime ku kane diskutuar nevojën e bashkepunimit ne grup, prezantimin e çeshtjeve apo nevojave qe i bashkon dhe se si mund ti



zgjidhin apo adresojne ato se bashku, si per çeshtje teknike, te inpleteve, teknologjise, te tregut, te infrastruktures bujqesore ato ligjore etj.

Lehtësuesit krahas takimeve individuale dhe ne grupe te vogla me fermeret per mbledhjen e informacionit, kane iniciuar dhe realizuar nga 6 takime me çdo grup. Jane identifikuar dhe kane marre pjese ne takime ne total rreth 365 fermere: per Korçen 230 fermere, Dibren 70 dhe per Kukusin 65 fermere, ku shumica prej tyre kane nenshkruar memorandumet.

### 1.3.2. Takimet e keshilluesve me grupet:

Keshilluesit e ADAD Malore kane marre pjese ne tre takime te cdo grupi te organizuar nga lehtesuesit. (shihni aneksin 1). Ne takimet e tyre ata kane shpjeguar rolin e ADAD Malore te angazhuar nga SARED sipas kontrates per komponentin e rritjes se kapaciteteteve (CD) dhe harmonizimi ndermjet komponenteve te projektit SARED. Gjithashtu ata kane diskutuar direkt me fermeret, kryesisht per problemet, aktivitetet dhe mundesine e aplikimit me projekte prane komponentit te granteve te SARED apo aktoreve te tjere. Mbeshtetur ne informacionin nga lehtësuesit dhe diskutimet qe jane bere ne takimet me grupet sipas temave, është sintetizuar dhe

pergjithesuar informacioni i mbledhur, i cili është rishqyrtuar me fermeret pjesemarres ne takimet e ardhshme. Ky informacion ka sherbyer si baze per hartimin e projekt propozimeve sipas iniciativave. Ne keto takime kane marre pjese dhe specialistet e ekstensionit te Drejtorise Bujqesive dhe per Korçen dhe



specialisti i QTTB. Ne tre takimet trajtuar tre tema: **tema e pare;** percaktimi i objektiveve, identifikimi i produkteve dhe i tregjeve te synuara, **tema e dyte;** trajtimi i modelit te plan biznesit i prezantuar nga SARED ne workshopet e Korces dhe te Dibres. Informacioni i grumbulluar eshte sistemuar sipas modelit te biznesit, **tema e trete;** percaktimi i aktiviteteteve, hartimi dhe shqyrtimi i marreveshjeve te grupeve. Jane identifikuar grupet, produktet kryesore, burimet e disponueshme, burimet e pa disponueshme, prodhimet dhe menyra e shitjes etj., te cilat jane pasqyruar ne projekt propozimet sipas iniciativave.

Si rezultat i punes me grupet nga lehtesuesit dhe keshilluesit e ADAD Malore, jane identifikuar tre grupe kryesore burimesh te padispunueshme ose pjeserisht te padispunueshme:

- Teknologjia e prodhimit - forma e kultivimit, krasitja, nenshartesa dhe varietetet, cilesia e inputeve bujqesore, fidane, plehera, pesticide, analizat e tokes, ushqimi dhe ujitja e pemes, demtimi nga bresheri etj.,
- Problemet e pasvjeljes, teknikat e vjeljes, mungesa e kapaciteteve ruajtese (dhomat frigoriferike), cilesia e dobet e frutave te molles, qe vjen nga mosndjekja teknike e pemtores, veshtiresi penetrimi ne treg etj.
- Probleme te infrastruktures bujqesore - mungesa e rrjeteve te ujitjes, burokracite ligjore si pershembull mungesa e dhenies se lejeve te ndertimit per dhoma frigorifike, ulja e TVSH-së per inputet apo naften, ceshtje keto qe i takojne pushtetit vendor.

Ne keto takime eshte shqyrtuar dhe arritja e nje memorandumi bashkëpunimi ndermjet anetarve te grupit dhe ADAD Malore per te punar se bashku ne vitet e ardhshme, është rënë dakord midis palëve për formatin e tij. Memorandumi eshte firmosur ne nje takim tjetër me grupet te organizuar nga lehtësuesit, lideret e grupeve dhe perfaqesuesi i ADAD Malore.

## 1.4. Produkti i punes 10 javore me 14 grupet

### 1.4.1 Percaktimi i produkteve;

Produkti do te punohet eshte **specia e molles** per Korce, **molla dhe qeshia** per Dibren dhe **kumbulla dhe molla** per Kuketin. Mund te theksojme se per Kuketin per nga sasia e siperfaqes si produkt kryesor paraqitet **arra**, por meqenese pemetoret jane me moshe te re 4-5 vjecare, duhene akoma dhe 4-5 vjet qe te futen ne prodhim, por gjithesesi perben nje potencial per te ardhmen dhe ne duhet te trajtojme teknologjine e kultivimit. Prodhuesit posedojne pemetore me moshe te ndryshme nga 1 deri 15 vjecare, ku dominon teknologjia ekstensive me distanca relativisht te medha dhe me pak pemetore intensive, me dendesi te larte dhe forme kurore te vogla ose forma aks. Ka shumellojshmeri varietetesh te molles, qershise, por dominojne varietetet tradicionale dhe pak jane futur varietete te reja sidomos ne molle dhe qershie. Vlen te theksojme se ne rajonin e Kuketit per kumbullen dominon varieteti autokton kumbulla e Hasit ose Tropojane, e cili meriton vemendje per te ardhmen.

#### 1.4.2 Organizimi i gjashte grupeve;

Pas nje pune te mire te lehtesuesve dhe keshilluesve ne bashkepunim me kordinatorët lokal te SARED dhe drejtuesit dhe specialistet e DB dhe QTBB, ne tre rajonet sipas termave te references, jane organizuar 14 grupe fermeresh; 8 ne rajonin e Korces, 3 grupe ne Diber, 1 grup ne Kukes dhe 2 grupe ne Has, ku bejne pjese fermere qe merren me sektorin e frutikutures dhe kane shkalle te ndryshme kapaciteti dhe zhvillimi te fermes.

#### 1.4.3. Memorandumet

Sic permendem me lart 306 fermere nga te tre rajonet qe kane marre pjese e takime, ne kuader te 14 grupeve kane nenshkruar 14 memorandumet me organizaten ADAD Malore. Kjo marreveshje ndermejt grupeve dhe ADAD Malore eshte shprehje vullneti dhe angazhimi per te punuar se bashku dhe per tu mbeshtetur nga ADAD Malore ne kuader te projektit SARED e me gjere per dy vitet e ardhshme. Kjo perben nje risi dhe njekohesisht krijon mundesi me te medha per te permiresuar teknologjine, per te investuar apo zgjidhur se bashku problemet e prodhimit dhe te tregut, apo per te adresuar ceshtje te ndryshme prane pushtetit vendor dhe qendror.



#### 1.4.4. Projekt propozimi – Draft,

Jane hartuar per 4 Iniciativa/Komponent – 5 Projekt Propozime ne dy gjuhe (shqip dhe anglisht) me konkretisht:

**Iniciativa WS 4-1a;** Korce per 6 grupet; Bilisht, Zemblak, Zvezde, Bulgarec, Qatrom e Qafzez

**Iniciativa WS 4-5a;** Korce per dy grupet Cangonj dhe Vranisht

**Iniciativa WS 4-6a;** Diber per grupet Tomin dhe Kastriot

**Iniciativa WS 4-2a;** Diber per grupin Ushtelenxe Diber

**Inisiativa WS 4-2a;** Kukes per grupet Koder Lume/ Kukes dhe Golaj – Zaharisht, Krume dhe Tregtan –Vranisht, Has.

Versionet paraprake te Projekt Propozimeve u jane derguar kordinatorëve rajonal te SARED, lehtesuesve dhe grupeve dhe verejtjet apo sugjerimet e tyre jane marre ne konsiderate ne finalizimin e Projekt Propozimeve. Projekt

Propozimet jane hartuar sipas modelit te prezantuar nga SARED ne workshopet e Korces dhe te Dibres.

### 1.5 Mobilizimi i ekipit teknik dhe te eksperteve qe jane perfshire ne projekt propozim

Gjate periudhes 10 javore 14 grupet e fermerëve kane shprehur nevoja per çeshtje te teknologjise, si per rritje te rendimentit apo cilesise se prodhimit edhe per ulje te kostove dhe aksesit ne treg. Ne pergjigje te ketyre nevojave ADAD Malore do te mobilizojë nje ekip prej 30 personash te perbere nga profesionistet me te mire te frutikultures ne vend. Gjithashtu per tema te avancuara dhe te rendesishme do te perfshihen 3 ekspert te huaj. Ne ekip jane perfshire:

- 4 Profesor te Universitetit Bujqesor te Tiranes ;
- 3 Pedagog (2 jane Doktore Shkencash) te fakultetit ekonomik te Univerisitit te Tiranes;
- 3 Profesor te Universitetit F. S. Noli Korce (per ushqimin, ujitjen dhe mbrojtjen fitosanitare);
- 1 ekspert i QTTB dhe edhe 3 ekstensionistë te DB Korce.
- 3 eksperte te huaj; 2 franceze (inovacionet teknologjike dhe organizimi filieres se molles) dhe 1 ekspert i huaj per tregun.
- 4 ekspert dhe 5 lehtësues te ADAD Malore.
- 4 ekstensioniste te DB Diber dhe DB Kukes/Has

Bashkengjitur ne projekt propozime gjenden CV perkatese te eksperteve.

Vizioni yne eshte qe ky ekip do te sjelle prurje te reja per çdo teme te trajtuar, do te ofroje zgjidhje bashkekohore dhe eficiente te probleme te fermerëve, dhe njohurite e reja do tu sherbejne fermerëve per nje periudhe te gjate ne te ardhmen, duke perforcuar kapacitetet teknike dhe profesionale te tyre. Gjithashtu mobilizimi i ketij ekipi do ta bej me efikas bashkepunimin nder-institucional dhe do te kete koherence ne perdorimin e njohurive dhe zbatimin e teknologjive te reja ne zinxhirin e vleres te frutave dhe arroveve. Per rrjedhoje do te arrihet fuqizimi i grupeve, rritja e prodhimit, shitjeve dhe te ardhurave – dhe si përfundim një zhvillim i qendrueshem i frutikultures.

### 1.6. Mobilizimi i aktoreve Korçë

Pas perfundimit te takimeve me grupet kemi bere perseri takime me aktoret e Korces; Kryetarin e Bashkise Korce z. Sotiraq Filo. me Drejtoret e DB dhe QTTB Korce z. Vullnet Gjolla dhe Roland Mecaj, me Rektorin e Universitetit F.S. Noli Korce



me z. Gjergji Mero, ku kemi diskutuar ecurine e takimeve me grupet dhe kemi rene dakort qe ne projekt propozimin qe do te prezantohet ne SARED nga ADAD Malore te perfshihen apo angazhohen, specialistet e DB dhe QTTB Korce, pedagoget e universitetit F. S. Noli sipas temave dhe aktiviteve te propozuara nga grupet.

Pas takimeve ne vijim, ADAD Malore me mbeshtetjen e FERT, se bashku me Bashkine Korce inicioi nje takim me date 3 Shkurt me aktoret e Korces (Qarku dhe Bashkia Korce, DB dhe QTTB Korce, Shkolla e Mesme Profesionale Bujqesore Korce, ADAD Malore/Fert) per bashkepunimin dhe koherencen ne zhvillimin e sektorin e frutikultures ne Korce, si sektori me i rendesishem ekonomik, jo vetem per Korcen por dhe per vendin. Ne perfundim te takimit palët pjesëmarrëse ranë dakord për krijimin e forumit të frutikulturës në Korçë, si edhe të kete takime periodike ne baze te nje programi pune.

## 2. Disa ndryshime ne lidhje me iniciativat

Pas takimeve me grupet, ne kemi vene ne dijeni kordinatoret lokal të SARED Korce, Kukes dhe Berthold Wohlleber –zyra SARED Tirane per disa ndryshime te vogla ne si me poshte:

1. Grupi Borsh/Devoll te emertohet- Grupi Bilisht sepse perfshin fermere te se njeites zone nga dy fshatrat Borsh dhe Verlne.
2. Grupi nga Qatrom/Drenove te emertohet Grupi Mollaj per te njeiten arsye, fermeret i perkasin te njeites zone ne dy fshatra Qatrom dhe Mollaj.
3. Grupi Bulgarec te kaloj nga **Iniciativa 5a**, «Bashkëpunimi midis fermerëve vegjël - e vetmja mënyrë për të rritur fuqinë negociuese të fermerëve», tek **Iniciativa 1a**, « Përmirësimi i teknologjive përmes trajnimit, këshillimit dhe demonstrimeve do të sjellë përmirësime në cilësinë e prodhimit dhe rritje të produktivitetit me të paktën 30 %», sepse ky grup ka nevojë per permiresimin e teknologjise.
4. Grupi Vranisht te kaloj nga **Iniciativa 1a**, Përmirësimi i teknologjive përmes trajnimit, këshillimit dhe demonstrimeve do të sjellë përmirësime në cilësinë e prodhimit dhe rritje të produktivitetit me të paktën 30 %, tek **Iniciativa 5a**. «Bashkëpunimi midis fermerëve vegjël - e vetmja mënyrë për të rritur fuqinë negociuese të fermerëve» se bashku me grupin Cangonj sepse kane me shume prodhim dhe dhoma frigoriferike, gjithashtu Cangonja dhe Vranishti kane filluar dhe eksportin e molles, keshtu qe i bashkon i njeiti aktivitet.
5. Per grupin e Kukesit, lehtesuesi Sefedin Mata u terhoq ne momentin e fundit dhe ADAD Malore ne konsultim me Drejtuesit e Kukesit vendosi ta

zevendesoje me lehtesuesin e Hasit z. Mevlan Cahani, i cili kishte mundesine per ti realizuar takimet me grupin e Kukesit.

## Aneksi 1

*Tabela 1: 150914 Tabela permbledhese e termave te references - Iniciativat e ADAD Malore*

Rajoni	Iniciativa /Komponenti	Numri i grupeve	Vendndodhja	Emri i lehtesuesit	Eksperti I ADAD Malore
Korce	WS 4-1a, Permiresimi I teknologjise nepermjet trajnimeve – keshillimeve dhe demonstrimeve do te permiresoje cilesine dhe prodhimin dhe do te rrise produktivitetin me te pakten 30%	6	Bilisht Zemblak, Zvezde, Bulgarec Qatrom Qafzez	Mehmet Pupa  Adlir Krushova	Blendi Shima  Kadri Malja  Hafuz Domi
Korce	WS 4- 5a, Bashkepunimi midis fermereve te vegjel si menyra e vetme per te rritur fuqine negociuese te fermereve	2	Cangonj Vranisht	Mehmet Pupa	Liljana Isakaj
Diber	WS 4-2a: Permiresimi I performances se zhvillimit ekonomik nw zinxhirin e vleres se frutave dhe arroveve nepermjet trajnimit te fermereve dhe specialisteve te ekstensionit	1	Ushtelenxe	Burhan Shehi	Hafuz Domi
Diber	WS 4, 4b; Krijimi I tre grupeve te bashkepunimit ne I. Tomin, Kastriot dhe ne II. Slllove, si modele per tu shperndare edhe ne rajone te tjera	2	Tomin, Kastriot	Burhan Shehi	Hafuz Domi
Kukes /Has	WS 4-2a: Permiresimi I performances se zhvillimit ekonomik nw zinxhirin e vleres se frutave dhe arroveve nepermjet trajnimit te fermereve dhe specialisteve te ekstensionit, Has/Kukes.	3	Golaj, Zaharisht, Vranisht, Tregtan, Fajza Koder Lume,	Mevlan Cahani	Hafuz DOMI  Liljana Isakaj

Tabela 2: 1a. Lista e lehtësuesve, specialisteve të DB/QTTB Korçe dhe ekspertet e ADAD

Iniciativa	Grupi	Lehtësuesi	Specialisti DB Korçe	Specialisti QTTB Korçe	Ekspertet
1a;	Bilisht/Borsh	Mehmet Pupa	Ardian Xama	-	Kadri Malja
	Zemblak	Mehmet Pupa	Fuat Isa	Namik Bebri	Blendi Shima
	Zvezde	Adlir Krushova	Fuat Isa	-	Blendi Shima
	Bulgarec	Adlir Krushova	Robert Mucolli	-	Liljana Isakaj
	Qatrom/Mollaj	Adlir Krushova	Tatjana Stefa	-	Hafuz Domi
	Qafzez	Adlir Krushova	Robert Tallo	-	Hafuz Domi
5a;	Vranisht	Mehmet Pupa	Ardian Xama	Namik Bebri	Kadri Malja
	Cangonj	Mehmet Pupa	Ardian Xama	Namik Bebri	Liljana Isakaj

Tabela 3: Lista e lehtësuesve, specialisteve të DB Diber dhe ekspertet e ADAD

(Component)	Vendi	Lehtesuesi	Specialiste të DB Diber	Keshillues Adad Malore
2a;	Ushtelenxe	Burhan Shehi	Jahja Ashiku	Hafuz Domi
6a;	Tomin	Burhan Shehi	Jahja Ashiku	Hafuz Domi
	Kastriot	Burhan Shehi	Avni Koltraka	

Tabela 4: Lista e lehtësuesve, specialisteve të DB Kukës/Has dhe ekspertet e ADAD

Iniciativa/ Komponenti	Grupi/Vendi	Emri i lehtesuesit	Emri i stafit të ADAD Malore	Spec. e ekstensionit DB Kukës/Has
2a;	<ul style="list-style-type: none"> <li>Krume (Golaj, Zaharisht)</li> <li>Fajza (Vranisht, Tregtan)</li> </ul>	Mevlan Cahani	Hafuz DOMI	Sadik Xhafa Rifat Mulaj
2a;	<ul style="list-style-type: none"> <li>Kukës (Koder Lume)</li> </ul>	Mevlan cahani	Liljana Isakaj	Sherif Visha

Tabela 5: Lista permbledhese te 14 grupeve

Rajoni	Iniciativa	Emri i Grupit	Nr. fermervet sipas memorandumit
Korce	WS 4-1a	bilisht	23
		zemblak	21
		zvezde	27
		bulgarec	24
		qatrom	24
		qafzez	26
Korce	WS 4-5a	vranisht	24
		cangonj	21
<b>Korca</b>			<b>190</b>
Diber	WS 4-2a	Ushtelenxe	20
Diber	WS 4-6a	Tomin	22
		Kastriot	24
<b>Dibra</b>			<b>66</b>
Has	WS 4-2a	Krume	17
		Fajza	15
Kukes		Kukes	18
<b>Kukesi</b>			<b>50</b>
<b>Total (1+2+3)</b>			<b>306</b>